



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E AVOKATISË  
STUDIO LIGJORE I.M & L.V  
NIPT: L81612025P**

Adresa: Rr. "M.Shyri", Pall. 5, Shk. 2, Tiranë. Tel: +355696556848, +355692175416;  
e-mail: [irena\\_meta@yahoo.com](mailto:irena_meta@yahoo.com), [lejlaveselaj@hotmail.com](mailto:lejlaveselaj@hotmail.com)

**STATUTI  
I SHOQËRISË "MEDIA GROUP CONNECTS" SH.P.K  
(Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar)**

Sot në datën 21/01/2019(dymijee nentembdhjete), përpara zyres se Avokatise, perfaqsuar nga Avokatet Lejla Veselaj dhe Irena Meta, anëtare e Dhomës së Avokatise Tiranë, me zyre Avokatie Rruga "Myslym Shyri", Pall. 5, Shk. 2, Tiranë, paisur me Nipt L81612025P, u paraqiten personalisht me cilesine e ortakeve themelues dhe nenshkruesve:

**ORTAKET:**

1. **Xhulio Zefi , i biri i Gjergjit, lindur ne Shkoder dhe banues ne Tirane, me adrese Rruga Prokop Myzeqari, ndertesa 12, identifikuar me leter njoftimiID, me numer personal, J71113073V, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar,**
2. **Artan Guzi , i biri i Skenderit,lindur ne Gramsh dhe banues ne Tirane,me adrese : Rruga "Muci Zade", banese private, Laprake,identifikuar me leter njoftimi ID, me numer personal, I60806085D, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.**

Te cilet, me cilesine e Ortakeve te Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, kane vendosur me vullnetin te tyre te lire dhe te plote, krijimin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar.

**Neni 1  
EMRI I SHOQËRISË**

Emri i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar do te jete:"**MEDIA GROUP CONNECTS "**  
**SH.P.K**

(Qe ketu e me poshte referuar si "Shoqeria")

**Neni 2**  
**SELIA E SHOQËRISË**

**Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në Tirane Shqiperi, ne Adresen Rruga “ Labinot”, pallati 2 shkalla 11, kati 2,ap 86 .**

Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale, zyra perfaqesimi, ne te gjithe vendin, brenda ose jashte territorit te vendit, gjate aktivitetit te saj.

**Neni 3**  
**KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë e pakufizuar, duke filluar që prej datës së rregjistrimit të saj në Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

**Neni 4**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

**Objekti i veprimtarise se Shoqërisë është si vijon:**

- a) Publikim media online (PAMFLETI)
- b) Tv online (PAMFLETI)
- c) Radio online (PAMFLETI)
- d) Teknologji informacioni
- dh) Botime print
- e) Montim strukturash mbajtese per display led.
- f) Montim display led per pubblicitete, reklama.
- g) Shoqëria do të kryejë cdo veprimtari tjeter te ofrimit të shërbimeve të ndryshme online perfshire ketu sherbimet te reklamimit të produkteve dhe shërbimeve , si ndaj personave fizike apo shoqëri tregtare, shërbime në fushën e komunikimeve elektronike, dixhitale, grafike, të medias etj.
- h) Organizim eventesh kulturore
- i) Gjithashtu, shoqëria mund te ushtroje cdo aktivitet qe ligji dhe rregullorja e lejojne .



#### Neni 5

Kjo Shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë kapitalin sipas vendimeve të Asamblese se Pergjithshme dhe sipas parashikimeve të ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare" me ndryshimet perkatëse.

#### Neni 6

### KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali fillestar i Shoqerise është 100.000 (nje qind mije) Leke dhe i ndarë në 2 kuota, në raport me kontributin e dhene nga sejcili ortak .

Kapitali zotërohet 100% nga ortakët e shoqerise si me poshte:

- **Z . Xhulio Zefi** , i cili do të zoterojë 1( nje) kuote, që përfaqëson( e barabarte) me përqindje kapitali prej 50% të kapitalit të Shoqerise.
- **Z. Artan Guzi** i cili do të zoterojë 1( nje) kuote, që përfaqëson( e barabarte) , me përqindje kapitali prej 50% të kapitalit të Shoqerise.

Ortakët e shoqerise mund të vendosin të rrisin kapitalin e Shoqerise në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me vendim të Asamblese se Pergjithshme të Shoqerise. Detyrimet e ortakëve të shoqerise kundrejt Shoqerise do të mbulohen vetëm me pjesën e kapitalit të paguar prej tyre.

#### Neni 7

Kapitali i shoqerise mund të shtohet ose të zvogëlohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit të Asamblese se Jashtëzakonshme të Ortakëve të Shoqerise.

#### Neni 8

### REGJISTRIMI I SHOQERISE

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky Statut si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar në datën e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit ( QKB).



**Neni 9**  
**KALIMI I KUOTAVE**

Pjesët shoqërore të ortakëve përpunohen me pjesën e tyre në kapitalin e shoqërisë. Kuotat e kapitalit të shoqërisë si dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nepermjet :

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes së kuotave
- c) trashëgimise
- d) dhurimit
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

Pjesët e tij çdo ortak i shoqërisë mund t'ua ofrojë të tretëve, të cilët nuk janë anetare në shoqëri. Ortaku i cili ka vendosur të transferojë apo shesë kuotat e tij, duhet të drejtojë një kërkesë me shkrim Organit Administrativ duke saktësuar cmimin e shitjes, i cili duhet të jetë i arsyeshëm dhe të jetë i njëjtë me atë që do t'i ofrohet dhe një personi të tretë jashtë shoqërisë si dhe të dhënat e blerësit.

E drejta e përparsisë për nënshkrimin e kapitalit është në proporcion me kuotat e secilit prej ortakëve.

Personi që kalon kuotën dhe ai që fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidarë ndaj shoqërisë, për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës nga casti i kalimit të kuotave deri në castin e regjistrimit të kalimit.

Shoqëria rregjistron kalimin e kuotave sipas nenit 43 të ligjit 9723 datë 03.05.2007. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

**Neni 10**

Emertimi i shoqërisë tregtare, kapitali themeltar, emri i administratorit, duhet të jenë të përmendura në të gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqëri dhe që ju drejtohen të tretëve. Shoqëria ka vullenë e saj me madhësi të zakonshme dhe me përbajtjen përreth saj.

**Neni 11**

Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër vetë të drejtat dhe detyrimet kontraktore

Organet e shoqërisë janë:

- 1- Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.
- 2- Administratori



**Neni 12**  
**KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME**

Per menyren e drejtimit dhe ushtrimit te aktivitetit te shoqerise, Ortaket shprehen me vendime per gjithshka qe eshte ne kompetencat e tyre te pershkruara si me poshte:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

**Neni 13**

Marrja e vendimeve te Asamblese se Pergjithshme, rregjistrohet ne rregjistrin e vendimeve te Asamblese se Pergjithshme, mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te, duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.

**Neni 14**  
**THIRRJA E ASAMBLESE**

Asambleja e Pergjithshme thirret sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise. Mbledhja e zakonshme e Asamblese se Pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit.

Asambleja e Pergjithshme thirret nga Administratori ose nga ortaket te cilet perfaqesojne te pakten 5 % te totalit te votave ne Asamblese e Pergjithshme te Shoqerise .

Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nepermjet postes elektronike 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e Asamblese. Njoftimi ne te dyja format e mesiperme duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites.

Asambleja perbehet nga pese anetare te cilet jane:

Dy ortaket e Shoqerise,

Eksperti Kontabel.

Dy perfaqesueset ligjore te shoqerise .



**Neni 15**  
**PJESËMARRJA NE VENDIME**

Cdo ortak, ka te drejte te marre pjese ne vendime si dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne te pakten 30% te kuotave.

Ne rastin kur Asambleja duhet te vendose per ceshtje qe kerkojne shumice te kualifikuar si per shembull ndryshime ne statut, zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit te rregjistruar, shperndarja e fitimeve, riorganizimi dhe shperndarja e Shoqerise, ajo mund te marre vendime te vlefshme kur vendos me **tre te katertat** e votave te ortakeve pjesemarrës personalisht, ose qe votojne me shkrese apo me mjete elektronike.

**Neni 16**  
**ADMINISTRIMI**

Shoqeria administrohet nga dy administratore te cilet caktohet ne statutin e Shoqerise dhe me pas nga Vendimet e Asamblese se Pergjithshme.

\*Administratoret detyrohen te kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqerise si dhe politikat e redaksionale dhe teknike te saj, duke respektuar kopetencat e dhena nga asambleja e pergjithshme.

\*Administratoret kujdesen per mbajtjen sakte dhe te rregullt te dokumenteve, dhe te librave kontabel te shoqerise.

\* Administratoret pregatisin dhe nenshkruan bilancin vjetor te shoqerise, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve ja paraqet keto dokumente asamblese se pergjithshme te ortakeve per miratim.

\*Administratoret kane te gjitha kompetencat per te vepruar me tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqerise ja jep shprehimisht asambleja e ortakeve.

**Administratori emerohet me nje afat prej pese vjetesh.**

\*Administratoret nuk i lejohet te kontraktoje me te tretet ne cfaredo lloj forme qofte, nuk i lejohet te marri hua tek shoqeria, te jape pelqimin per ceshtje te ndryshme ne emer te saj, nuk i lejohet te jape paradhenie, te behet dorezanes apo te garantoje ne emer te shoqerise apo te ortakeve etj, pervec rasteve kur ai ka marre nje miratim perkates me shkrim nga asambleja e ortakeve.

\*Administratoret kane te drejte te kryejne vetem ato veprime te cilat kane te bejne me administrimin e perdritshem dhe te zakonshem te shoqerise. Administratoret mund te japi prokura tek te tretet brenda kufijve qe ligji e lejon dhe ne kufijte qe i lejon Asambleja e



Ortakeve per kategori te caktuara veprimesh.

\*Te gjitha veprimet e tjera duke perfshire pagesa, detyrime per tu paguar, veprime me insitucionet bankare ku perfshihen transferta bankare terheqje parash etj, do te kryhen nga administratoret.

**Administratore te Shoqerise jane caktuar Artan Guzi dhe Gjergj Zefi .**

**Neni 17**  
**MARRËDHENIET E PUNES**

Mardheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj Shoqerie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj Shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

**Neni 18**  
**KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga Administratoret e Shoqerise.

**Neni 19**  
**EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABËL**


Kontrolli mbi veprimtarine e shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e Shoqerise i besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te emerohet dhe qendroje ne detyre sipas parashikeve te ligjit perkates. Asambleja e Ortakeve cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

**Neni 20**  
**VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE**  
**Viti financiar dhe bilanci vjetor**

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit. Administratoret marrin masat me qellim hartimin e bilanceve, rezultateve ekonomike te fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit te ceshtjeve te mesiperme si dhe shlyerjen e detyrimeve, te ardhurat e tjera do ti kalojne ortakeve te shoqerise.

**Neni 21**  
**SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

Ne rast se shoqeria shperndahet per cdo lloj arsye Asambleja e Pergjithshme percakton menyren e likuidimit, emerone nje ose me teper likuidator dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c'rregjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Rregjistrimit.



**Neni 22**  
**LIBRAT E SHOQERISE**

Po kështu shoqëria në bazë të ligjit mban librat e mëposhtem:

- 1) Libri i Asamblese së Pergjithshme
- 2) Libri i vendimeve të organit administrativ.
- 3) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve të eksperteve ose revizoreve kontabel.

**Neni 23**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Përsa është shprehur në këtë statut i referohemi ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët Dhe Shoqëritë Tregtare", dhe ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendren Kombëtare të Rregjistrimit". Çdo ndryshim bëhet në përputhje me këtë Statut dhe nuk prek personalitetin juridik të kësaj Shoqërie.

Autorizohen avokatet, Av. Irena Meta dhe Av. Lejla Veselaj për të kryer të gjitha procedurat e rregjistrimit të shoqërisë "：“**MEDIA GROUP CONNECTS** ”” SH.P.K. dhe depozitimimin e akteve në Qendren Kombëtare të Biznesit ( QKB) .

Ky Statut u hartua prej Avokateve , në katër kopje me përmbajtje të njëjta. Ky Statut iu lexua me zë të lartë dhe të qartë ortakëve themelues,

**Ortakët themelues** me deklaruan se e konsiderojnë në përputhje me vullnetin e tyre dhe me ligjin. Ky Statut nënshkruhet para Avokateve. Në avokatet e vertetojmë në bazë të ligjit.

**ORTAKET E SHOQERISE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR**

**“MEDIA GROUP CONNECTS ” SH.P.K**

**ORTAKET:**

1. Xhulio Zefi *Xhulio Zefi*

2. Artan Guzi *Artan Guzi*

*Artan Guzi*

*Artan Guzi*



*Lejla Veselaj*  
*Irena Meta*